Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues _____	*Data e autorizimit të ekspertit:* **08.06.2022**	*Data e dorëzimittë raportit:* **14.06.2022**	*Nr. i lëndës:* **185, 188 /22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **04.06.2022**, OE ankues: **"Sinjalizimi" Sh.p.k. – Vraniq, Suharekë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **185/22**, kurse, me datën: **06.06.2022**, OE ankues: **"Lindi Markings" Sh.p.k. – Vitomiricë, Pejë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **188/22**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës),**lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në Komunën e Pejës"** me nr. të prokurimit: **635-22-3284-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna e Pejës.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës:**Kontratë publike kornize – Shërbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **74.000,00 €**

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Sinjalizimi" Sh.p.k.– Suharekë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 - i LPP-së
Neni 6 - i LPP-së
Neni 7 – i LPP-së
Neni 59 – i LPP-së
Neni 60 – i LPP-së
Neni 56 – i RRUOPP-së
Neni 108/A – i LPP-së

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Te nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se me dt. 20.05.2022, ku keni rekomanduar për kontrate OE **ER – LIS SH.P.K.,** ndërsa neve na keni shpallur si tenderues te pasuksesshëm.

Ju sqarojmë se ju si AK me rekomandimin për kontrate te OE te lartcekur keni bere shmangie nga kriteri sipas FDT Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Nr. Nenit 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional**, *Dëshmia e kërkuar dokumentare*, **Dëshmia 3. Lista e pajisjeve duhet te dorëzohet ne origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuar dhe njëra nga këto dëshmi kopje te librezës se qarkullimit, ose DUD doganore, ose fature për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen.**

Dëshmia 4. Koja e Katalogut

OE **ER – LIS SH.P.K.,** nuk ka ofruar asnjë dëshmi me DUD doganor apo fature për blerje për pajisjet e kërkuara, si dhe marrëveshjen mbi qira te prezantuar nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara për posedim te këtyre pajisjeve me DUD doganore apo fature për blerje nga qiramarrësi. Gjithashtu, OE **ER – LIS SH.P.K.,**nuk ka ofruar asnjë katalog mbi produktet e shenjëzimit horizontal dhe vertikal.
Tek njoftimi mbi vendimin e AK-se formulari B58 ju keni shënuar si ne vijim "*Komuna e Pejës* **shpërblen** me kontratë Operatorin Ekonomik: **ER – LIS SH.P.K**., nga Peja me **vlere 41.515,00 euro**"
Ju e keni shpallur fitues OE e rekomanduar për kontrate me vlere 41.515,00, ndërsa ne ju sqarojmë se ligji i prokurimit publik nuk parasheh qe fitues te shpallet ndonjë operatore ekonomik nëse nuk plotëson kërkesat sipas FDT te lartcekura, prandaj keni vepruar ne kundërshtim me LPP dhe dosjen e tenderit.

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qartë se ju si AK na keni diskriminuar neve duke mos na rekomanduar për kontrate si OE i përgjegjshëm dhe duke e favorizuar OE te rekomanduar për kontrate, ku i njëjti eshë pse nuk ka prezantuar dokumentet e kërkuara sipas dosjes se tenderit ne FDT është rekomanduar për kontrate nga ana juaj.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u cekën me lartë rezulton se ekzekutimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 59 te LPP-se dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Ju nuk keni respektuar edhe nenin 7 i LPP-se, sepse na keni diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-se dhe njoftimit për kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*". Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; qe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*", mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu, ju si autoritet kontraktues nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse jeni të obliguar që të siguroni që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrë me ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Gjithashtu, ju si autoritet kontraktues nuk i keni respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktues në Kosovë.

Me date 26.05.2022 e pranuam vendimin e kërkesë për rishqyrtim ku AK refuzon si te jashtë afateshme ne kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A dhe kalkulimin e afateve kohore për faktin se data e vendimit për dhënie është 20.05.2022, ndërsa kërkesën për rishqyrtim e kemi parashtruar me date 25.05.2022 ne ora 11:17 qe rezulton te jete dita e 5-te, ndërsa AK e përdorë qëllimisht këtë arsyetim vetëm e vetëm për te mos trajtuar pretendimet tona ankimore ku i rekomanduari për kontrate do te eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit.

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrin:

VENDIM

APROVOHET,*si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE* **"Sinjalizimi" Sh.P.K.**
ANULOHET,njoftimi mbi Vendimin e AK-së për dhënie te kontratës dhe lënda kthehet ne **RISHQYRTIM** dhe gjate rishqyrtimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucione tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues si dhe Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë të njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Lindi Markings" Sh.p.k.– Pejë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 - i LPP-së
Neni 6 - i LPP-së
Neni 7 – i LPP-së
Neni 59 – i LPP-së
Neni 60 – i LPP-së
Neni 61 – i LPP-së
Neni 69 – i LPP-së
Rregullorja për çmime jo normalisht te ulëta.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Te nderuar ne me dt. 20.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim jemi njoftuar me njoftim mbi vendimin e AK-se, ku e ka rekomanduar për kontrate **OE "ER-LIS" Sh.p.k.,** ndërsa neve na ka shpallur si tenderues te pasuksesshëm.

Ju sqarojmë se AK-ja e ka rekomanduar për kontrate një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si ne vijim:

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit përkatësisht kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, ku kërkesë ka qene "Një liste e mjeteve te punës nga O.E

1. *Makinëpër piketim minimum 1 copë*
2. *Makinëpërshlyerjen e vijave minimum 1 copë*
3. *Makinëpër hapjen e gropave për vendosjen e shtyllave vertikale te shenjave te komunikacionit minimum 1 copë*
4. *Pajisje për sinjalizim horizontal (zebra dhe ishuj) te rrugëve minimum – 1 copë, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Lista e pajisjeve duhet te dorëzohet ne origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografi ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje te librezës se qarkullimit, ose DUD doganore, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen"*

OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ne ofertë ka prezantuar një marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve me kompaninë VE-MORE SH.P.K., e te cilës marrëveshje nuk i figuron data e nënshkrimit te saj, andaj si e tille e njëjta nuk mund te vërtetohet se a është nënshkruar para apo pas datës se hapjes se ofertave dhe e njëjta nuk duhet te merret parasysh fare.

Gjithashtu, nëse e kërkojmë ne ARBK kompaninë VE-MORE Sh.P.K., me te cilën OE i rekomanduar për kontrate ka lidhur marrëveshje për shfrytëzim te pajisjeve e te cilës ne këtë marrëveshje i figuron numri unik identifikues si ne vijim 810405713766066, kur kërkohet ne ARBK e njëjta kompani nuk figuron fare, andaj ne dyshojmë se marrëveshja e lartcekur është e falsifikuar dhe kërkojmë nga ju qe te detyroni AK ti verifikoj dyshimet tona.

Gjithashtu, OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ne lidhje me kërkesën e lartcekur i njëjti nuk i ka prezantuar dëshmitë e kërkuara kopje te librezës se qarkullimit, ose DUD doganore, ose fature për blerje ose Kontrata mbi qiramarrjen, mirëpo ka prezantuar vetëm fotografi te cilat nuk e tregojnë qartë gjendjen faktike, se i njëjti OE i posedon pajisjet e ofruara me fotografi. Andaj si i tille OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm dhe i tille është dashur te konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo qe një veprim te tille nuk e njëjta nuk e ka bërë duke e favorizuar hapur OE te rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e ka përmbushur edhe kërkesën ne lidhje me stafin e kërkuar ne dosje te tenderit, për faktin se i njëjti nuk ka prezantuar fare vendim për caktimin e menaxherit te projekti, andaj ky OE është i papërgjegjshëm, mirëpo qe çuditërisht AK-ja e ka rekomanduar për kontrate.

OE i rekomanduar për kontrate po ashtu ka ofertuar me çmim jo normalisht te ulet, mirëpo qe AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt, e qe me këtë veprim te saj neve po na jap te kuptojmë se e njëjta nuk i ka analizuar fare ofertat ne tersi. Tabela e me poshtme e tregon qarte gjendjen faktike, ku shihet qarte se OE i rekomanduar për kontrate i plotëson kushtet për te qene oferte me çmim jo normalisht te ulët.

Nr.				
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	**Pranuar 7 oferta**		
2		1	49,895.00	
3		**2**	**41,515.00**	
4		3	51,000.00	
5		4	52,490.00	
6		5	52,945.00	
7		6	63,750.00	
8		7	73,800.00	
9		**Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)**	**385,395.00**	
10		**mesatarja (C8/6)**	**55,056.43**	
11	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**42,351.10**	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
12	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**45,359.09**	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 7 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C11
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C12
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 2 plotëson kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet si ofertë abnormalisht e ulët**	

Pra nga tabela e lartcekur kuptohet qarte se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim jo normalisht te ulët, mirëpo qe AK-ja nuk e ka parasysh këtë fakt.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet e lartcekura, shihet qarte se AK-ja ka rekomanduar për kontrate një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur te konsiderohet edhe nga ana e AK-se, mirëpo qe një gjë te tillë, nuk e ka bërë duke e favorizuar haptas OE te rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu edhe **OE SINJALIZIMI SH.P.K.,** i renditur si i dyti me çmim e te cilin AK-ja e ka konsideruar si te pasuksesshëm, ju sqarojmë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm dhe AK-ja është dashur ta konsideroj si te tillë.

OE i lartcekur është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i plotëson te gjitha kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate, përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë ***"Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për sinjalizime të ngjashme në vlerë prej 110.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 50% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e fundit".,*** ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar ***"Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve".,***

OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ne oferte ka prezantuar kontrata te cilat nuk e arrijnë vlerën e caktuar te kërkesa e lartcekur. Kur analizohet oferta e OE te lartcekur shihet qe i njëjti OE e ka prezantuar kontrata te cilat janë lidhur në vitin 2017, ndërsa ne po e përmendim vetëm njërën nga ato. Kontrata "*Shenjezimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave*" , e lidhur mes grupit te OE Sinjalizimi Sh.p.k.,& ZMAS doo dhe KK Prizren, e njëjta kontrate është nënshkruar medt. 06.07.2017. Përderisa kjo kontrate është lidhur mes KK Prizren dhe një grupi te konsorciumit, atëherë është e paqarte se sa është përqindja e punëve te kryera nga ana e OE Sinjalizimi Sh.p.k., dhe sa e OE ZMAS doo. Po ashtu kjo kontrate nuk ka te beje vetëm me sinjalizim po edhe me vendosje te barrierave e te cilat nuk përkojnë me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit.

Andaj ne kërkojmë nga ju qe te detyroni AK ti analizoj kontratat e prezantuara nga OE Sinjalizimi Sh.p.k., dhe pas vlerësimit te tyre te nxjerr një përfundim se a plotëson apo jo OE i lartcekur kërkesën ne lidhje me kontratat e përfunduar ne 3 vitet e fundit. Pasi qe siç edhe e cekem me lartë se nuk dihet se sa ka qene përqindja e punëve te cilat i ka përfunduar OE Sinjalizimi Sh.p.k., dhe sa anëtari tjetër i konsorciumit dhe gjithashtu nuk dihet përqindja e punëve te cilat kane te bëjnë me sinjalizim.

Po ashtu OE i larte cekur është i papërgjegjshëm dhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër te dosjes se tenderit, ku kërkesë ka qene "*Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrueshëm",*ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Deklarata e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K"***.**
OE i lartcekur te cilin AK-ja e ka cilësuar si OE te pasuksesshëm nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, për faktin se nuk ka prezantuar fare deklaratën e kërkuar sipas kërkesës se lartcekur. Pra i njëjti OE nuk ka prezantuar fare deklaratë ne lidhje me specifikimet teknike dhe si i tillëështë dashur te shpallet si OE i eliminuar, mirëpo qe AK-ja një veprim te tille nuk e ka ndërmarrë, duke e vërtetuar edhe një here pretendimin tonë, se AK-ja nuk i ka analizuar ne tërësi te gjitha ofertat e OE ofertues.

Gjithashtu edhe **OE Limit L & Sh.P.K.,** i renditur me çmim si i treti ne këtë aktivitet te prokurimit, e te cilin OE AK-ja e ka cilësuar si te pasuksesshëm, ju sqarojmë se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur te cilësohet edhe nga AK-ja.

OE i lartcekur është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate e ku kërkese ka qenë "*Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrueshëm",*ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Deklarata e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K"***.**

OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se kur analizohet oferta e tij ne këtë aktivitet te prokurimit, atëherë shihet qartë se te njëjtit OE i mungon specifikacioni teknik. Andaj përderisa te njëjtit i mungon specifikacion teknik, për ne është e çuditshme se si AK-ja e ka cilësuar këtë OE si te pasuksesshëm, ose siç duket nuk i ka analizuar ne tërësi ofertat e OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

Ne me dt. 26.05.2022kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim, e te cilën kërkesë për rishqyrtim AK-ja e ka cilësuar si te pa bazuar, mirëpo qe nuk e ka dhen enje arsyetim konkret ne lidhje me refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim.

AK-ja ne vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim e ka cekur se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, me arsyetimin se kinës pretendimet tona janë te pabazuar. Nëse eventualisht pretendimet tona do te ishin te pa bazuara atëherë AK-ja do te duhet ti arsyetonte te gjitha një nga një se përse te njëjtat pretendime janë te pa bazuara. AK-ja me mos shqyrtimin e pretendimeve tona nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 108/A paragrafi 9 ku theksohet shume qarte se " 9. *Refuzimi do te arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligje, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë."*

Përderisa AK-ja nuk e ka arsyetuar refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim, atëherë edhe një here po vërtetohet fakti se pretendimet tona ankimore qëndrojnë dhe se AK-ja edhe një here po e shfaq hapur favorizimin qe po i bën OE te rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet që u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene **tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, ku edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate nuk jemi rekomanduar për kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente*. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe **Gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) qe tenderi i zgjedhur te përputhet me te gjitha aspektet përmbajtsore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse**", mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.

Duke u bazuar ne dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa OE "Linda Markings" Sh.p.k. si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhënie te kantatës për dhe lënda kthehet ne RIVLERESIM,
DETYROHET, autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucione tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues si dhe Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë të njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

Kërkesat:	**Evidencat:**
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për sinjalizime të ngjajëshme në vler prej 110.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 50% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit.	Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve.
Kërkesa 2 Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 1 inxhinerë dhe minimum 1 teknik i trafikut rrugor Menaxheri i projektit të jetë Inxhinieri i diplomuar i Komunikacionit ,minimum 3 vite provoj pune pas diplomimit ,në lëmin e sinjalizimit. dhe Një teknik që ka të kryer shkollen e mesme të lart Drejtimi Trafik Rrugor.	Dëshmia 2 Për stafin professional(inxhinierët)dhe (teknikun) duhet te ken Diplomat-kopje kontrata (nëse nuk janë në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshje për angazhimin në ketë projekt) dhe CV-ja.

Kërkesa 3 Një liste e mjeteve te punës nga O.E 1. Makinë për e piketim minimum 1 copë 2. Makinë për shlyerjen e vijave minimum 1copë 3. Makine për hapjen e gropave për vendosjen e shtyllave vertikale te shenjave te komunikacionit minimum 1copë 4. Pajisje për sinjalizim horizontal (zebra dhe ishuj) te rrugëve minimum- 1 copë.	Dëshmia 3 Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen.
Kërkesa 4 Me oferte duhet te prezantohen katalogu dhe atestet, sipas paramases, cili do te përdoret ne teren.	Dëshmia 4 Kopja e katalogut
Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrushëm	Dëshmia 5 Deklarat e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE ER LIS SHPK është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin më të lirë Oferta e këtij është € 41 515.00

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden ne platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, si dhe sqarimet e kërkuar nga ESH te datës: 08.06.2022. dhe përgjigjet e pranuara nga ZPP – Komuna e Pejës në të njëjtën datë.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)
///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
///

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK me rekomandimin për kontrate te OE te lartcekur keni bere shmangie nga kriteri sipas FDT Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Nr. Nenit 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe profesional**, *Dëshmia e kërkuar dokumentare*, **Dëshmia 3. Lista e pajisjeve duhet te dorëzohet ne origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuar dhe njëra nga këto dëshmi kopje te librezës se qarkullimit, ose DUD doganore, ose fature për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen.**

Dëshmia 4. Koja e Katalogut

OE **ER – LIS SH.P.K.,** nuk ka ofruar asnjë dëshmi me DUD doganor apo fature për blerje për pajisjet e kërkuara, si dhe marrëveshjen mbi qira te prezantuar nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara për posedim te këtyre pajisjeve me DUD doganore apo fature për blerje nga qiramarrësi. Gjithashtu, OE **ER – LIS SH.P.K.,** nuk ka ofruar asnjë katalog mbi produktet e shenjëzimit horizontal dhe vertikal.

Tek njoftimi mbi vendimin e AK-se formulari B58 ju keni shënuar si ne vijim "*Komuna e Pejës* **shpërblen** me kontratë Operatorin Ekonomik: **ER – LIS SH.P.K**., nga Peja me **vlere 41.515,00 euro**"

Ju e keni shpallur fitues OE e rekomanduar për kontrate me vlere 41.515,00, ndërsa ne ju sqarojmë se ligji i prokurimit publik nuk parasheh qe fitues te shpallet ndonjë operatore ekonomik nëse nuk plotëson kërkesat sipas FDT te lartcekura, prandaj keni vepruar ne kundërshtim me LPP dhe dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne vijim:

Kërkesat:	**Evidencat:**
Kërkesa 3 Një liste e mjeteve te punës nga O.E 1. Makinë për e piketim minimum 1 copë 2. Makinë për shlyerjen e vijave minimum 1copë 3. Makine për hapjen e gropave për vendosjen e shtyllave vertikale te shenjave te komunikacionit minimum 1copë 4. Pajisje për sinjalizim horizontal (zebra dhe ishuj) te rrugëve minimum- 1 copë. Kërkesa 4 Me oferte duhet te prezantohen katalogu dhe atestet, sipas paramases, cili do te përdoret ne teren.	Dëshmia 3 Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen. Dëshmia 4 Kopja e katalogut

Operatori ekonomik ka ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi, ka prezantuar fotografi te pajisjeve si dhe ka prezantuar listën e pajisjeve te nënshkruar dhe te vulosur, po ashtu ka prezantuar edhe një Kontratë- marrëveshje për shfrytëzimin e makinerisë për këtë aktivitet te prokurimit me OE: VE-MORE SHPK me NUI: 810405713766066, përfaqësuar nga Agim Morina, duke shfrytëzuar te drejtën e bashpronësisë për te gjitha makinerinë e ne veçanti për makinerinë e kërkuar për realizimin e këtij projekti, (kjo kontratë nuk ka date dhe nuk dihet kur është lidhur kjo kontrate), gjithashtu, OE i rekomanduar për kontrate (ER LIS" SHPK), nuk ka prezantuar asnjë dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen, për te dëshmuar pronësinë e këtyre pajisjeve te kërkuar ne dosjen e tenderit për ketë aktivitet te prokurimit, përveç disa fotografive te pajisjeve. Ndërsa, lidhur me KATALOGUN OE i rekomanduar për dhënie te kontratës, ka prezantuar autorizim nga Helios Fabrika e bojrave, llaqeve dhe rrëshirave sintetike Količevo, d.o.o. Koliçevo 65 • 1230 Domžale, Slloveni, dhe katalogun nga HELIOS Materiale për shënjimin e rrugëve, duke siguruar sipërfaqe për siguri më të madhe dhe kundër rrëshqitjes në trafik HELIOCRYL, SIGNOCRYL, VERONIL, SIGNODUR, mirepo nuk ka ofruar katalog lidhur me sinjalizimin vertikal, por ka ofruar deklaratën për specifikacionin teknik. Prandaj, AK – komisioni i vlerësimit ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se me date 26.05.2022 e pranuam vendimin e kërkesë për rishqyrtim ku AK refuzon si te jashtë afateshme ne kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A dhe kalkulimin e afateve kohore për faktin se data e vendimit për dhënie është 20.05.2022, ndërsa kërkesën për rishqyrtim e kemi parashtruar me date 25.05.2022 ne ora 11:17 qe rezulton te jete dita e 5-te, ndërsa AK e përdorë qëllimisht këtë arsyetim vetëm e vetëm për te mos trajtuar pretendimet tona ankimore ku i rekomanduari për kontrate do te eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK ka ngritur ne platformën elektronike e-prokurim 058 – Njoftim mbi vendimin nga AK me date 20.05.2022 ne ora: 13:11 min., kurse OE ankues ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim ma datën 25.05.2022, ora: 11:17 min., përmes platformës elektronike, qe i bie 5 dite (25 ditë - 20 ditë = 5 ditë), sepse data e njoftimit te OE është dita zero (0) dhe pastaj fillon numërimi, duke mos u përgjigjur ne pretendimet e OE ankues, duke e trajtuar si te jashtë-afatshme, prandaj **AK – ZPP ka vepror ne kundërshtim me nenin 108/A par. 3 pika 3.2 te LPP-së,** ku thote: ***"në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së*** *njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit",* gjithashtu duke **shkelur nenin *4 par. 4.2 tek*** **Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave**, ku thotë: "*Autoriteti Kontraktues, respektivisht zyrtari përgjegjës i prokurimit, duhet te siguroj qe **data e publikimit** te Njoftimit për dhënie te kontratës / Rezultatit te konkursit te projektimit / Anulimit te aktivitetit te prokurimit, te jete **e njëjte me datën** kur Autoriteti Kontraktues zyrtarisht njofton Operatorin Ekonomik ne lidhje me rezultatin e aktivitetit te prokurimit. Ne rast te mospërputhjes se datave, mbizotëron data kur njoftimi me shkrim i dorëzohet Operatorit Ekonomik. Data e njoftimit është **"dita 0" e 5 ditëve të obligueshme të periudhës "në pezullim***",

po ashtu **AK – ZPP ka vepruar ne kundërshtim me nenin 44.3 te RRUOPP-së,** po citoj:

"Data e njoftimit të tenderuesve/kandidateve është "dita 0" e 5 ditëve të obligueshme të përiudhës "në pritje".

*Nëse njoftimi publikohet në ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon **ditën e premte** sepse:*

- ***Dita e premte është ditë pune***
- *Në përputhje me Nenin 4, paragrafi 4.2 të Rregullave për parashtrim të ankesave, data e njoftimit është **"dita 0" e 5 ditëve"**.*

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 59, 72, 108/A të LPP-së**, dhe **nenin 39.8 te RRUOPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Lindi Markings" Sh.p.k. - Pejë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit përkatësisht kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, ku kërkesë ka qene "Një liste e mjeteve te punës nga O.E

5. *Makinë për piketim minimum 1 copë*
6. *Makinë për shlyerjen e vijave minimum 1 copë*
7. *Makinë për hapjen e gropave për vendosjen e shtyllave vertikale te shenjave te komunikacionit minimum 1 copë*
8. *Pajisje për sinjalizim horizontal (zebra dhe ishuj) te rrugëve minimum – 1 copë, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Lista e pajisjeve duhet te dorëzohet ne origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografi ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje te librezës se qarkullimit, ose DUD doganore, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen"*

OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ne ofertë ka prezantuar një marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve me kompaninë VE-MORE SH.P.K., e te cilës marrëveshje nuk i figuron data e nënshkrimit te saj, andaj si e tille e njëjta nuk mund te vërtetohet se a është nënshkruar para apo pas datës se hapjes se ofertave dhe e njëjta nuk duhet te merret parasysh fare.

Gjithashtu, nëse e kërkojmë ne ARBK kompaninë VE-MORE Sh.P.K., me te cilën OE i rekomanduar për kontrate ka lidhur marrëveshje për shfrytëzim te pajisjeve e te cilës ne këtë marrëveshje i figuron numri unik identifikues si ne vijim 810405713766066, kur kërkohet ne ARBK e njëjta kompani nuk figuron fare, andaj ne dyshojmë se marrëveshja e lartcekur është e falsifikuar dhe kërkojmë nga ju qe te detyroni AK ti verifikoj dyshimet tona.

Gjithashtu, OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ne lidhje me kërkesën e lartcekur i njëjti nuk i ka prezantuar dëshmitë e kërkuara kopje te librezës se qarkullimit, ose DUD doganore, ose fature për blerje ose Kontrata mbi qiramarrjen, mirëpo ka prezantuar vetëm fotografi te cilat nuk e tregojnë qartë gjendjen faktike, se i njëjti OE i posedon pajisjet e ofruara me fotografi. Andaj si i tille OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm dhe i tille është dashur te konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo qe një veprim te tille nuk e njëjta nuk e ka bërë duke e favorizuar hapur OE te rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne vijim:

Kërkesat:	**Evidencat:**
Kërkesa 3 Një liste e mjeteve te punës nga O.E 1. Makinë për e piketim minimum 1 copë 2. Makinë për shlyerjen e vijave minimum 1copë 3. Makine për hapjen e gropave për vendosjen e shtyllave vertikale te shenjave te komunikacionit minimum 1copë 4. Pajisje për sinjalizim horizontal (zebra dhe ishuj) te rrugëve minimum- 1 copë. Kërkesa 4 Me oferte duhet te prezantohen katalogu dhe atestet, sipas paramases, cili do te përdoret ne teren.	Dëshmia 3 Lista e pajisjeve duhet të dorëzohet në origjinal, ku duhet ti bashkëngjiten, fotografit ku identifikohen pajisjet e kërkuara dhe njëra nga këto dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen ose Kontrata mbi qiramarrjen. Dëshmia 4 Kopja e katalogut

Operatori ekonomik ka ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi, ka prezantuar fotografi te pajisjeve si dhe ka prezantuar listën e pajisjeve te nënshkruar dhe te vulosur, po ashtu ka prezantuar edhe një Kontratë- marrëveshje për shfrytëzimin e makinerisë për këtë aktivitet te prokurimit me OE: VE-MORE SHPK me NUI: 810405713766066, përfaqësuar nga Agim Morina, duke shfrytëzuar te drejtën e bash pronësisë për te gjitha makinerinë e ne veçanti për

makinerinë e kërkuar për realizimin e këtij projekti, (kjo kontratë nuk ka date dhe nuk dihet kur është lidhur kjo kontrate), gjithashtu, OE i rekomanduar për kontrate (ER LIS" SHPK), nuk ka prezantuar asnjë dëshmi kopje të librezës së qarkullimit, ose DUD doganorë, ose faturë për blerjen, për te dëshmuar pronësinë e këtyre pajisjeve te kërkuar ne dosjen e tenderit për këtë aktivitet te Prokurimit, përveç disa fotografive te pajisjeve. Prandaj, AK – komisioni i vlerësimit ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e ka përmbushur edhe kërkesën ne lidhje me stafin e kërkuar ne dosje te tenderit, për faktin se i njëjti nuk ka prezantuar fare vendim për caktimin e menaxherit te projekti, andaj ky OE është i papërgjegjshëm, mirëpo qe çuditërisht AK-ja e ka rekomanduar për kontrate.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si ne vijim:

Kërkesa 2 *Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 1 inxhinerë dhe minimum 1 teknik i trafikut rrugor Menaxheri i projektit të jetë Inxhinieri i diplomuar i Komunikacionit ,minimum 3 vite provoj pune pas diplomimit ,në lëmin e sinjalizimit. dhe Një teknik që ka të kryer shkollen e mesme të lart Drejtimi Trafik Rrugor.*	*Dëshmia 2* *Për stafin professional(inxhinierët)dhe (teknikun) duhet te ken Diplomat-kopje kontrata (nëse nuk janë në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshje për angazhimin në ketë projekt) dhe CV-ja.*

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ka prezantuar z. Enver Biçku – Inxhinier i diplomuar i Makinerisë-Drejtimi Komunikacionit, diploma kopje e notrizuar, CV-ja dhe kontrata - marrëveshja për angazhim ne këtë projekt, mirëpo tek kërkesa është kërkuar, ku thotë: "*Menaxheri i projektit të jetë Inxhinieri i diplomuar i Komunikacionit ,minimum 3 vite provoj pune pas diplomimit ,në lëmin e sinjalizimit",* prandaj AK – zyrtari i prokurimit gjate hartimit te dosjes se tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve – ofertave nga OE, nuk ka specifikuar si duhet te dorëzohet vendimi me shkrim për emërimin e menaxherit te projekti, prandaj OE nuk duhet te eliminohen apo pësojnë pa fajin e tyre, për gabimet e AK, (*tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*), duke mos e specifikuar saktë se me çka te dëshmohet), sepse vlerësimi behet ne përputhje me kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne FDT, dhe AK – Komisioni i vlerësimit ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm**

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontrate po ashtu ka ofertuar me çmim jo normalisht te ulet, mirëpo qe AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt, e qe me këtë veprim te saj neve po na jap te kuptojmë se e njëjta nuk i ka analizuar fare ofertat ne tersi. Tabela e me poshtme e tregon qarte gjendjen faktike, ku shihet qarte se OE i rekomanduar për kontrate i plotëson kushtet për te qene oferte me çmim jo normalisht te ulët.

Nr.				
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 7 oferta		
2		1	49,895.00	
3		2	41,515.00	
4		3	51,000.00	
5		4	52,490.00	
6		5	52,945.00	
7		6	63,750.00	

8		7	73,800.00	
9		**Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)**	**385,395.00**	
10		**mesatarja (C8/6)**	**55,056.43**	
11	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**42,351.10**	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
12	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**45,359.09**	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 7 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C11
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C12
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 2 plotëson kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë mund të konsiderohet si ofertë abnormalisht e ulët**	

Pra nga tabela e lartcekur kuptohet qarte se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim jo normalisht te ulët, mirëpo qe AK-ja nuk e ka parasysh këtë fakt. Duke u bazuar ne te gjitha faktet e lartcekura, shihet qarte se AK-ja ka rekomanduar për kontrate një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur te konsiderohet edhe nga ana e AK-se, mirëpo qe një gjë te tillë, nuk e ka bërë duke e favorizuar haptas OE te rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP nuk kane vepruar ne pajtim te plote me **Neni 4 Procedura e shqyrtimit *(inter partes)- B57* Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, konkretisht neni 4.2** , po citoj: *"Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkoj me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët***", prandaj AK nuk ka e trajtuar fare çmimin e OE te rekomanduar për dhënie te kontratës edhe përkundër se plotësohen kushtet (sikurse ne tabelën me larte) sipas **nenit 3 te *B57* Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, po citoj:**

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te **gjitha kushtet e mëposhtme:**

i. çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (**tre) tenderë.**

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ne oferte ka prezantuar kontrata te cilat nuk e arrijnë vlerën e caktuar te kërkesa e lartcekur. Kur analizohet oferta e OE te lartcekur shihet qe i njëjti OE e ka prezantuar kontrata te cilat janë lidhur në vitin 2017, ndërsa ne po e përmendim vetëm njërën nga ato. Kontrata "*Shenjezimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave*" , e lidhur mes grupit te OE Sinjalizimi Sh.p.k.,& ZMAS doo dhe KK Prizren, e njëjta kontrate është nënshkruar me dt. 06.07.2017. Përderisa kjo kontrate është lidhur mes KK Prizren dhe një grupi te konsorciumit, atëherë është e paqarte se sa është përqindja e

punëve te kryera nga ana e OE Sinjalizimi Sh.p.k., dhe sa e OE ZMAS doo. Po ashtu kjo kontrate nuk ka te beje vetëm me sinjalizim po edhe me vendosje te barrierave e te cilat nuk përkojnë me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit.
Andaj ne kërkojmë nga ju qe te detyroni AK ti analizoj kontratat e prezantuara nga OE Sinjalizimi Sh.p.k., dhe pas vlerësimit te tyre te nxjerr një përfundim se a plotëson apo jo OE i lartcekur kërkesën ne lidhje me kontratat e përfunduar ne 3 vitet e fundit. Pasi qe siç edhe e cekem me lartë se nuk dihet se sa ka qene përqindja e punëve te cilat i ka përfunduar OE Sinjalizimi Sh.p.k., dhe sa anëtari tjetër i konsorciumit dhe gjithashtu nuk dihet përqindja e punëve te cilat kane te bëjnë me sinjalizim.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, se OE "Sinjalizimi" Shpk, nga Suhareka ka prezantuar listën kontratave si dhe ka prezantuar procevrbalin mbi pranimin teknik te datës 29.07.2020 për projektin: Shenjezimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave ne rrugët e Prizrenit – Loto 2 – Shenjezimi horizontal" , me numër prokurimi: 622-16-086-511, ne vlere prej 358,039.06 €, nga konsorciumi i OE: "Sinjalizimi" Shpk & "ZMAS" doo nga Dubova e Sllovenisë, ku ne këtë proces verbal thuhet se me kërkesën e Konsorciumit te bere me date: 06.07.2017 me nr. prok.: 05-370-01-59621 për pranimin e punimeve te kryera, prandaj duke marr per baze te dhënat te cilat jane pjese e këtij procesverbali, përveç qe mbanë datën 29.07.2020, te gjitha te dhënat tjera janë jashtë pjerdhurës brenda tri viteve te fundit nga njoftimit për kontrate, ashtu siç është kërkuar tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale te FDT, dhe duke marr parasysh këto te dhëna ne këtë procesverbal te pranimit teknik, atëherë ne mënyrë qe AK – komisioni i vlerësimit te sigurohet se ky projekt/kontrate plotëson kërkesën e AK te përcaktuar ne dosje te tenderit, ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm**

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i larte cekur është i papërgjegjshëm dhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër te dosjes se tenderit, ku kërkesë ka qene "*Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrueshëm",*ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Deklarata e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K"***.**
OE i lartcekur te cilin AK-ja e ka cilësuar si OE te pasuksesshëm nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, për faktin se nuk ka prezantuar fare deklaratën e kërkuar sipas kërkesës se lartcekur. Pra i njëjti OE nuk ka prezantuar fare deklaratë ne lidhje me specifikimet teknike dhe si i tillë është dashur te shpallet si OE i eliminuar, mirëpo qe AK-ja një veprim te tille nuk e ka ndërmarrë, duke e vërtetuar edhe një here pretendimin tonë, se AK-ja nuk i ka analizuar ne tërësi te gjitha ofertat e OE ofertues.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE "Sinjalzimi" Shpk, ka dorëzuar aneksin 1 te FDT-se, te nënshkruar dhe te vulosur, qe do te thotë se operatori ekonomik e ka shikuar, analizuar dhe pranuar specifikimin teknik – Aneksin 1 te FDT-se, edhe përkundër faktit se nuk ka ofruar një deklarate me shkrim, kjo nënkupton dhe zëvendëson deklaratën, dhe bazuar ne **nenin 47.19 te RRUOPP-se "*Neni 59.4 i LPP-së** gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur"*, kjo është nen përgjegjësin e komisionit te vlerësimit dhe konsideroj se është trajtuar drejte ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-se , si me larte. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Bashkangjitur me ketë raport gjeni Aneksin 1 te FDT-se te nënshkruar dhe vulosur nga OE "Sinjalizimi" Shpk.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i lartcekur është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate e ku kërkese ka qenë "*Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrueshëm",* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Deklarata e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K"***.**

OE i lartcekur nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se kur analizohet oferta e tij ne këtë aktivitet te prokurimit, atëherë shihet qartë se te njëjtit OE i mungon specifikacioni teknik. Andaj përderisa te njëjtit i mungon specifikacion teknik, për ne është e çuditshme se si AK-ja e ka cilësuar këtë OE si te pasuksesshëm, ose siç duket nuk i ka analizuar ne tërësi ofertat e OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE "Limit L & B " Shpk, ka dorëzuar deklaratën për specifikimet teknike lidhur me kete aktivitet te prokurimit me titull dhe numër prokurimi, ku thotë: deklarojmë se jemi njoftuar dhe pranojmë specifikimin teknike ne DT" dhe AK – komisioni i vlerësimit ka vepruar ne pajtim te plote me dispozitat ligjore te LPP-se. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Bashkangjitur me këtë raport gjeni Aneksin 1 te FDT-se te nënshkruar dhe vulosur nga OE "Limit L&B" Shpk.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se NE me dt. 26.05.2022 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim, e te cilën kërkesë për rishqyrtim AK-ja e ka cilësuar si te pa bazuar, mirëpo qe nuk e ka dhen enje arsyetim konkret ne lidhje me refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim.

AK-ja ne vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim e ka cekur se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, me arsyetimin se kinës pretendimet tona janë te pabazuar. Nëse eventualisht pretendimet tona do te ishin te pa bazuara atëherë AK-ja do te duhet ti arsyetonte te gjitha një nga një se përse te njëjtat pretendime janë te pa bazuara. AK-ja me mos shqyrtimin e pretendimeve tona nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 108/A paragrafi 9 ku theksohet shume qarte se " 9. *Refuzimi do te arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligje, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë."*

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka pranuar kërkesë për rishqyrtim me date 26.05.2022, ndërsa ZPP ka pezulluar aktivitetin e prokurimit ne platformën elektronike, duke vepruar ne pajtim me **nenin 108/A par. 2 te LPP-së,** ku thotë: "*Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*", pastaj ZPP me date 26.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke mos vepruar ne pajtim te plote me **nenin 108/A par. 9 te LPP-se**, ku thotë: "*Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë."* si dhe **nenin 108/A par. 12 te LPP-se, ku thotë:** *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë",* që do të thotë se AK – ZPP ka qene i obliguar te veproj ne pajtim te plote sipas neneve dhe sqarime si me larte, pasi qe vendimi i nxjerr nga ZPP i datës 26.05.2022 i mungon pjesa kryesore – dispozitivi (arsyetimi i refuzimit te kërkesë për rishqyrtim), si dhe nuk është ngritur ne platformën e-prokurim ashtu siç kërkon njoftimi **Nr.15/2020 i nxjerr nga KRPP me date 28.01.2020**, ku thotë, përgjigjet t'i ngarkoni tek funksion "dosja e tenderit" si dokument shtesë. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 59, 61, 72, 108/A të LPP-së**, dhe **nenin 39.8 te RRUOPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE: *1. "Sinjalizimi" Sh.p.k.* dhe *2. "Lindi Markings" Sh.p.k.*, **të aprovohen si të bazuar**, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim** duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Komuna e Pejës*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "Sinjalizimi" Sh.p.k. – Vraniq, Suharekë*
- *OE ankues – "Lindi Markings" Sh.p.k. –Vitomiricë, Pejë*